

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **POLICIA E KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	214-25-6778-5-1-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: **Ndertimi dhe renovimi I stacionit Policor Rahovec**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NBT-ING SH.P.K. & AGIM TROLLI B.I.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Sopijë

(Adresa)

Suharekë

23000

(Vendi)

(Kodi postar)

+383 49 340 328

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Bexhet Baftjaraj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

nbting2008@gmail.com

(Adresa elektronike)

23.03.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 14.08.2025
Data e hapjes së ofertave: 06.10.2025
Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 06.03.2026
Kërkesa për rishqyrtim dt:11.03.2026
Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dt:13.03.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Hapja elektronike në platformën e E-Prokurimit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 61 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 66 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 25 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik
Neni 40, 41, 60, 64, i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik
Neni 10 i Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik (me ndryshimet e 002/2024)

** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne, **Grupi i Operatorëve Ekonomikë NBT-ING SH.P.K. & AGIM TROLLI B.I.**, kemi pranuar **Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (Formulari B58)** të datës **05.03.2026**, të nxjerrë nga **Policia e Kosovës**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Ndërtimi dhe Renovimi i Stacionit Policor Rahovec – Rivlerësim”**, me **nr. të prokurimit 214-25-6778-5-1-1**.

Si Operator Ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë të prokurimit, konsiderojmë se vendimi i Autoritetit Kontraktues për **shpërblimin me kontratë të Grupit të Operatorëve Ekonomikë N.T. “Fer-Petroll”**; **MBB Construction SH.P.K.**, si dhe eliminimin e ofertës sonë nga procedura e vlerësimit, është marrë në kundërshtim me dispozitat e **Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës**, dokumentet e dosjes së tenderit dhe parimet themelore të trajtimit të barabartë dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik.

Vlen të theksohet se kjo procedurë është kthyer në **rivlerësim me vendim të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)**, me ç’rast Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar që të bëjë një **rivlerësim të plotë, objektiv dhe në përputhje me arsyetimin e vendimit të OSHP**, duke respektuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe dispozitat përkatëse të LPP-së. Megjithatë, nga analiza e vendimit të fundit të Autoritetit Kontraktues rezulton se rivlerësimi nuk është kryer në mënyrë të drejtë dhe të plotë, pasi që oferta jonë është eliminuar mbi bazën e një interpretimi të gabuar të procedurës së vazhdimit të validitetit të ofertës, ndërsa njëkohësisht është rekomanduar për kontratë një operator ekonomik i cili **nuk përmbush në mënyrë të plotë kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit**, veçanërisht në lidhje me përmbushjen e kriterëve për përvojë të ngjashme dhe dëshmimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale.

Në këto rrethana, konsiderojmë se vendimi i Autoritetit Kontraktues është rezultat i një **interpretimi të gabuar të kërkesave të dosjes së tenderit dhe i një vlerësimi jo të plotë të ofertave**, gjë që bie ndesh me dispozitat e **Ligjit për Prokurimin Publik**, në veçanti me parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe vlerësimit të drejtë të ofertave.

Për këto arsye, përmes kësaj kërkesë për rishqyrtim kërkojmë që **Autoriteti Kontraktues të rishqyrtojë vendimin e marrë, të anulojë vendimin për shpërblim me kontratë dhe të bëjë një rivlerësim të drejtë dhe të plotë të ofertave në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe dokumentet e tenderit.**

1. Argumenti i AK për eliminimin e ofertës tonë:

B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar ⁴

05.03.2026, Prishtinë

POLICIA E KOSOVES, Rr "Luan Haradinaj"- nr. 99 ndërtesa e re e Administratës te Policisë, kati II, zyra e Prokurimit nr. 33, Prishtinë, Kosovë

Operatori Ekonomik NBT-ING SH.P.K.; Agim Trolli B.I.

Nr. i Prokurimit:	214-25-6778-5-1-1
Nr i brendshëm	214/25/092/511

Titulli: NDËRTIMI DHE RENOVIMI I STACIONIT POLICOR RAHOVEC RIVLERESIM

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04 /L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP" Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

- Grupi I OE është i papërgjegjshëm pasi nuk ka bërë vazhdimin e validitetit të ofertës dhe sigurimit sipas kërkesës së AK të datës 29.12.2025.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qenë në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

1. Kundershtimi i argumenteve të AK:

Sa i përket arsyes së eliminimit të Grupit të Operatorëve Ekonomikë NBT-ING SH.P.K. & Agim Trolli B.I., përkatësisht konstatimit të Autoritetit Kontraktues se OE nuk ka bërë vazhdimin e validitetit të ofertës dhe sigurimit sipas kërkesës së AK të datës 29.12.2025, konsiderojmë se ky konstatim është i pabazuar si në aspektin juridik ashtu edhe në aspektin faktik.

Së pari, duhet theksuar se kjo procedurë është **kthyer në rivlerësim me vendim të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)**, me ç'rast Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të bëjë një rivlerësim të plotë dhe objektiv të ofertave. Në këtë situatë, eliminimi i operatorit ekonomik vetëm mbi bazën e një elementi procedural të mëhershëm, pa një rivlerësim real të ofertës dhe pa marrë parasysh rrethanat aktuale të procedurës, nuk është në përputhje me qëllimin dhe efektin juridik të vendimit të OSHP.

Së dyti, Grupi i Operatorëve Ekonomikë **NBT-ING SH.P.K. & Agim Trolli B.I.** është i gatshëm dhe në gjendje të bëjë vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës dhe të sigurimit të ofertës sipas kohëzgjatjes së kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, dhe në kuadër të kësaj kërkesë për rishqyrtim do të paraqesë edhe vazhdimin përkatës të validitetit të ofertës dhe sigurimit. Kjo dëshmon qartë se oferta jonë mbetet valide dhe e garantuar sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

Së treti, qëllimi i kërkesës për validitet të ofertës dhe sigurim nuk është eliminimi formal i operatorëve ekonomikë kur ata janë në gjendje të sigurojnë vazhdimin e tyre, por garantimi që oferta të mbetet e vlefshme gjatë procedurës së prokurimit. Në këtë rast, duke qenë se OE ka bërë dhe po paraqet vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës dhe sigurimit sipas kërkesës së AK, **arsyeja e eliminimit nuk qëndron dhe si e tillë duhet të rishqyrtohet.**

Për këto arsye, konsiderojmë se eliminimi i Grupit të Operatorëve Ekonomikë **NBT-ING SH.P.K. & Agim Trolli B.I.** mbi këtë bazë është i pabazuar dhe kërkojmë që Autoriteti Kontraktues ta anulojë këtë konstatim dhe ta përfshijë ofertën tonë në një **rivlerësim të drejtë dhe të plotë të ofertave**, në përputhje me vendimin e OSHP dhe me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

2. Argumenti i AK për dhënije të kontratës:

	Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo Qeveria - Vlada - Government Ministria e Punëve të Brendshme Ministarstvo Unutrašnjih Poslova Ministry of Internal Affairs	
	Policia e Kosovës / Policia Kosova / Kosovo Police Drejtoria e Përgjithshme e Policisë / Generalna Policijska Direkcija / General Police Directorate	

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹
Sipas Nenet 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: NDERTIMI DHE RENOVIMI I STACIONIT POLICOR RAHOVEC
RIVLERESIM

Nr. i prokurimit ²	214-25-6778-5-1-1
Nr i brendshëm	214/25/092/511

Nr.	Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave	Vlera totale e Korigjuar
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik SH.P.K.; Agim Trolli B.L.	488,546.40 €	490,546.40 €
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik N.T. „Fer-Petroll; MBB Construction SH.P.K..	518,765.00 €	N/A
3.	NPN EUROING SH.P.K. XËRXË, RAHOVEC	646,152.60 €	644,352.60 €
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik 2A Group SH.P.K.; AXIOM ENGINEERING SH.P.K.	574,477.47 €	598,057.47 €
5.	HARST Group SH.P.K.	650,779.40€	649,339.40€

Policia e Kosovës për këtë aktivitet të prokurimit, shpërblen me kontratë Grup i Operatorëve Ekonomik N.T. „Fer-Petroll; MBB Construction SH.P.K. me çmim në vlerë totale të ofertës prej 518,765.00 €

Data: 06/02/2026

Emri dhe mbiemri i ZPP: Miran Fejza

¹ Këtë formulari i bashkangjiten edhe letrat standarde të njoftimeve: B42, B45 dhe B46 (shtoni letra njoftuese sipas nevojës).

² Të raportohet në qdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

2. Kundershtimi i argumentuar i vendimit të AK:

Sa i përket vendimit të Autoritetit Kontraktues për shpërblimin me kontratë të Grupit të Operatorëve Ekonomikë N.T. “Fer-Petroll”; MBB Construction SH.P.K., konsiderojmë se ky vendim është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me gjetjet dhe konstatimet e vetë Autoritetit Kontraktues të evidentuara gjatë procedurës së vlerësimit.

Nga dokumentacioni zyrtar i nxjerrë nga Autoriteti Kontraktues (letra standarde **B42 për tenderuesin e eliminuar**), rezulton se për të njëjtin Operator Ekonomik AK ka konstatuar se oferta e tij është **administrativisht e papërgjegjshme**, pasi që OE nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit në lidhje me përvojën e ngjashme. Konkretisht, sipas vetë gjetjeve të Autoritetit Kontraktues, operatori ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë kontrata të përfunduara të natyrës së njëjtë në vlerën minimale të kërkuar sipas Dosjes së Tenderit.

Në këtë dokument, vetë Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se nga lista e kontratave të paraqitura janë pranuar vetëm kontrata në vlerë totale rreth **284,710 €**, që është dukshëm më e ulët se kërkesa minimale e përcaktuar në Dosjen e Tenderit prej **800,000 €**, duke

konstatuar qartë se OE nuk e plotëson këtë kriter të rëndësishëm të kapacitetit teknik dhe profesional.

Në këto rrethana, është juridikisht e pakuptueshme që i njëjti Operator Ekonomik, i cili sipas gjetjeve të vetë Autoritetit Kontraktues nuk përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe është cilësuar si **administrativisht i papërgjegjshëm**, të rekomandohet për shpërblim me kontratë. Një veprim i tillë krijon një kundërthënie të qartë ndërmjet konstatimeve faktike të Autoritetit Kontraktues dhe vendimit përfundimtar për shpërblimin e kontratës, duke e bërë vendimin e fundit të pabazuar dhe juridikisht të paqëndrueshëm.

Për më tepër, edhe në aspektin ekonomik vendimi i Autoritetit Kontraktues është i pajustificuar. Oferta e Grupit të Operatorëve Ekonomikë **NBT-ING SH.P.K. & Agim Trolli B.I.** është dukshëm më e favorshme për Autoritetin Kontraktues, me vlerë prej **488,546.40 €**, ndërsa oferta e OE të rekomanduar për kontratë është në vlerë **518,765.00 €**, pra rreth **30,000 € më e lartë** se oferta jonë.

Në përputhje me parimet themelore të **Ligjit për Prokurimin Publik**, Autoriteti Kontraktues është i obliguar të sigurojë përdorimin sa më ekonomik dhe efikas të fondeve publike dhe të shpërblejë kontratën për ofertën ekonomikisht më të favorshme që përmbush të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Në këtë rast, përveç se oferta jonë është më e ulët dhe më ekonomike, Autoriteti Kontraktues vetë ka konstatuar se OE i rekomanduar nuk përmbush kriteret e kërkuara në Dosjen e Tenderit. Për rrjedhojë, vendimi për shpërblimin e kontratës jo vetëm që është ekonomikisht i pafavorshëm për Autoritetin Kontraktues, por është edhe juridikisht i pabazuar.

Për këto arsye, bazuar në gjetjet e vetë Autoritetit Kontraktues dhe në krahasimin objektiv të ofertave, konsiderojmë se vendimi për shpërblimin me kontratë të OE **N.T. “Fer-Petroll”**; **MBB Construction SH.P.K.** është marrë në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe me parimet e Ligjit për Prokurimin Publik, dhe si i tillë duhet të **anullohet dhe të bëhet një rivlerësim i drejtë dhe i plotë i ofertave.**

Duke u bazuar në argumentet e paraqitura më sipër, konsiderojmë se vendimi i Autoritetit Kontraktues për shpërblimin me kontratë të Grupit të Operatorëve Ekonomikë **N.T. “Fer-Petroll”**; **MBB Construction SH.P.K.** është marrë në kundërshtim me gjetjet e vetë Autoritetit Kontraktues gjatë procesit të vlerësimit, si dhe në kundërshtim me parimet dhe dispozitat e **Ligjit për Prokurimin Publik.**

Nga dokumentacioni zyrtar i nxjerrë nga Autoriteti Kontraktues rezulton qartë se operatori ekonomik i rekomanduar nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit në lidhje me përvojën e ngjashme, ndërkohë që oferta e Grupit të Operatorëve Ekonomikë **NBT-ING SH.P.K. & Agim Trolli B.I.** është ekonomikisht më e favorshme dhe plotëson kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Në këto rrethana, vendimi për shpërblimin e kontratës nuk është në përputhje me parimet e **transparencës, trajtimit të barabartë dhe përdorimit ekonomik të fondeve publike**, të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik.

Prandaj, kërkojmë nga **Organi Shqyrtues i Prokurimit** që në kuadër të kompetencave të tij ligjore:

- të **pranojë këtë ankesën si të bazuar,**
- të **anulojë vendimin për shpërblimin e kontratës,** dhe
- të **rivlersim të plotë të ofertave në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.**

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse oferta jonë është e përgjegjshme dhe i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

V E N D I M

1. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e **NBT-ING SH.P.K. & AGIM TROLLI B.I.**
2. **ANULOHET**, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM**,
3. **DETYROHET** autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkakuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00€.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.

